



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.21.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës së Shtërpcës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu, i mbështetur nga Milosh Petroviq (udhëheqës i ekipit) dhe anëtari Nebojsa Ristic.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	13
4 Qeverisja.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	26
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	29


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të komunës së Shtërpcës veriore për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet ndërkombëtarisht në njohura të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë e auditimit ka përfshirë testet për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 20/11/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opiniononi

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opiniononeve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opiniononi i Auditorit të Përgjithshëm është:


Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Si *Theksim të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e pasurive në PVF nuk është e plotë.


(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e komunës janë:







Përgjigjja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i komunës është pajtuar me të gjitha gjetjet tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

Ne e marrim si punë të kryer faktin që Kryetari:

- Të diskutojë raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit janar/shkurt 2016 të inicojë diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e komunës së Shtërpcës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmvive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë e auditimit fokusohet në vlerësimin dhe të kuptuarit e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të rezultateve cilësore operacionale. Për sisteme individuale financiare kërkojmë identifikimin e nivelit deri ku funksionojnë kontrollet, kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit. Ajo poashtu merret me edhe me raportimin lidhur me obligimet.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna e Shtërpcës nuk ka arritur ta adresojë gabimin material lidhur me plotësinë e pasurive të paraqitura në PVF. Përveç kësaj mangësie, cilësia e PVF në përgjithësi është e mirë dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat e raportimit me një numër të vogël të gabimeve jo materiale të identifikuar. Të gjitha obligimet e tjera për raportim janë përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosja e pasurive në PVF nuk është e plotë.

(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 20.11.2014, është identifikuar një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e prezantimit të pasurive. Po ashtu, gjatë auditimit është vërejtur edhe një rrezik domethënës lidhur me prezantimin e pagesave nga palët e treta. Këto janë rreziqe të anomalive materiale të cilat mund të rezultojnë me opinion të modifikuar.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar lidhur me prezantimin e pagesave nga palët e treta nuk ka ndodhur sepse, pas këshillave tona, menaxhmenti kishte bërë korrigjimet e nevojshme në PVF.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 – Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive të prezentuara në PVF

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive kapitale për vitin 2014. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar vlerë të plotë të pasurive në PVF. Megjithatë, rreziku i identifikuar ishte materializuar për shkak se menaxhmenti nuk ka arritur t'i kryej përmirësimet e nevojshme të kontrollit të brendshëm dhe ne kemi vërtetuar se vlera e pasurisë në PVF për vitin 2014 ishte jo e plotë dhe e pasaktë (shih çështjen 15).

Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë – Kryetari duhet të analizojë arsyet për përsëritjen e gabimit në paraqitjen e vlerave të pasurive në PVF dhe pamundësinë e komunës për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e gabimit. Veprimet e duhura shtesë nga ana e menaxhmentit janë që të gjitha pasuritë me vlerën mbi 1,000€ të regjistrohen fillimisht në regjistrin kontabël, dhe më pastaj, e njëjta shumë të prezantohet në PVF të vitit 2015. Ky proces duhet të jetë nën monitorim direkt nga ana e Kryetarit.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna e Shtërpcës duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese për PVF dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesa buxhetore;
- Nëse PVF janë dorëzuar me kohë në Ministrinë e Financave në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Raportet e vet-vlerësimit sipas rregullave të MFK;
- Raportin për obligimet e papaguara;
- Planin preliminar dhe final të prokurimit;
- Raportet e rregullta tremujore pranë Kuvendit Komunal dhe MF; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Të gjitha kërkesat për raportim ishin përmbushur me përjashtim të çështjes së prezantuar në vijim.

Rekomandimet

Çështja 2 - Përgatitja e Pasqyrave Financiare - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Për shkak të procesit joefektiv të rishikimit nga menaxhmenti, i aplikuar për PVF, ne kemi identifikuar që shpalosjet mbi pasuritë e komunës nuk janë të sakta dhe të plota (shih çështjen 1). Si rezultatë, 'Deklarata' e bërë nga Kryetari dhe ZKF të cilës i jemi referuar më lartë nuk është e saktë në të gjitha aspektet.
- Rreziku** PVF-të të cilat nuk janë subjekt i një rishikimi të nivelit të lartë nga menaxhmenti potencialisht do të përfshijnë gabime materiale të cilat shpiejnë tek një opinion i modifikuar apo theksim i çështjes.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve për 2015 të përfshijë një rishikim kritik nga menaxhmenti të draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në draft PVF janë zbatuar kontrollet e nevojshme.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përpiluar një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve tona të vitit 2013. Janë ndërmarrë veprime të kufizuara.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar në 13 rekomandime.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, vetëm 1(një) rekomandim ishte adresuar plotësisht dhe 4 (katër) janë adresuar pjesërisht, derisa 8 (tetë) të tjerat nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i Lartë

E gjetura Vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të vitit të kaluar ishte trajtuar, sepse Menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-it.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve ka pasur pasojë PVF jo të plota, përsëritje të dobësive me rastin e planifikimit të buxhetit dhe rezervimit të mjeteve financiare, menaxhimin e pasurive, menaxhimin e të hyrave, certifikimin jo të rregullt të shpenzimeve me rastin e blerjes së mallrave, dhe shërbimeve dhe me rastin e dhënies së subvencioneve.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në të cilin do të definohen qartë mënyrat e zbatimit të rekomandimeve, afatet kohore dhe zyrtarët përgjegjës. Kryetari i komunës duhet t'i jep prioritet rekomandimeve të rëndësisë më të madhe, dhe drejtpërdrejt ta mbikëqyrë zbatimin e tyre.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Qeverisja e fortë e mbështet planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve kyçe të komunës. Aspektet kryesore të kornizës së qeverisjes të cilat mund të adresohen nga komuna e Shtërçës përfshijnë:

- Përmirësimet në fushën e raportimeve menaxheriale nuk është i mjaftueshëm, në të njëjtën kohë raportimi brendshëm për rezultatet e arritura nuk është zhvilluar sa duhet. Aspekti formal i tij kërkon përmirësime;
- Menaxhimi i rrezikut – ku komuna nuk ka zbatuar një proces formal dhe të dokumentuar të vlerësimit të rrezikut;
- Vetëvlerësimi – një raport i vetë vlerësimit është dorëzuar në MF, por ky raport ka nevojë për vështrime kritike dhe krahasim të objektivave dhe rezultateve; dhe
- Sistemi i auditimit të Brendshëm, ku nevojitet një program i bazuar në vlerësim të rrezikut dhe nevoja për formimin dhe mbështetjen nga një komitet efektiv i auditimit.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Qeverisja ka të bëjë me sistemin përmes të cilit menaxhohen dhe kontrollohen organizatat. Qeverisja efektive kërkon planifikim, monitorim dhe aranzhime të rrepta raportuese të cilat në mënyrë të qartë i adresojnë rreziqet operationale dhe strategjike me të cilat përballet një organizatë.

Rekomandimet

Çështja 4 – Korniza qeverisëse – Prioritet i Lartë

E gjetura	Nuk ka një raportim formal dhe sistematik që i ndërlidh objektivat e komunës. rëndësia e përpilimit të raporteve cilësore operative dhe financiare nuk është kuptuar sa duhet. Raportimi i menaxhmentit duhet të bëhet në mënyrë të standardizuar. Kjo ka bërë që ne mos të mbështetemi në nivelin e lartë të kontrollit në çasjen tonë audituese.
Rreziku	Mos raportimi adekuat dhe i vonuar i menaxhmentit të lartë e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për menaxhim efektiv të aktiviteteve të komunës dhe reagimin me kohë ndaj sfidave financiare dhe operative. Kjo mund të rezultojë me dobësi të ndryshme me suficit apo deficit të paplanifikuar.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet vendos një strukturë funksionale të raportimit përmes së cilës menaxhmenti i lartë do të informohet me kohë dhe në mënyrë adekuate për të gjitha mangësitë eventuale në sistemin e raportimit. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e aranzhimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe kërkesave me qëllim të përmbushjes së objektivave të komunës.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	3,135,923	3,396,920	2,984,537	2,975,584	4,003,868
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,831,423	3,044,010	2,762,469	2,732,894	3,764,988
Të bartura nga viti paraprak ²	0	48,410	48,394	94,326	50,745
Të hyrat vetanake ³	304,500	304,500	173,674	113,121	136,698
Donacionet e jashtme	0	0	0	35,243	51,437

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 260,997€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së Grantit të Qeverisë për 212,587€, dhe bartjes së të hyrave vetjake 2013 në shumë 48,410€. Komuna e Shtërpçës në vitin 2014 ka shpenzuar 88% të buxhetit final që është një performancë e përmirësuar në raport me vitin 2013 (83%). Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	3,135,923	3,396,920	2,984,537	2,975,239	4,003,868
Pagat dhe Mëditjet	1,780,000	1,992,587	1,757,373	1,450,596	1,434,355
Mallrat dhe Shërbimet	290,469	290,592	252,265	439,266	334,963
Shërbimet komunale	138,471	138,471	117,685	95,970	82,546
Subvencionet dhe Transferet	53,023	53,040	10,165	7,484	4,999
Investimet Kapitale	873,960	922,230	847,049	981,923	2,147,005

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 212,587€ ka ndodhur për shkak të vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave për 25%. Komuna e Shtërpcës ka shfrytëzuar vetëm 88% të buxhetit të aprovuar për shkak se në shëndetësinë sekondare ende nuk është plotësuar numri i punëtorëve të lejuar;
- Suficiti për mallra dhe shërbime në vlerë prej 38,327€ është rezultat i shkurtimeve për 15%, në bazë të vendimit të Qeverisë; Situatë e ngjashme paraqitet edhe te buxheti për shërbime komunale;
- Buxheti për subvencione është shpenzuar vetëm 19% dhe komuna nuk ishte në gjendje të jepë shpjegime. Kjo ka ndodhur sepse komuna nuk ka vendosur kontrolle efektive për të siguruar zbatimin e planeve të përcaktuara;
- Megjithë rritjen e buxhetit për investime kapitale për 48,271€, niveli i shpenzimeve ishte 92%. Megjithatë, kjo shumë nuk e paraqet gjendjen reale të investimeve kapitale për projektet e realizuara gjatë vitit 2014, sepse me vendim të gjykatës për obligimet e viteve të kaluara ishin paguar 401,080€ apo 47% e shpenzimeve aktuale; dhe
- Edhe në vitin 2014 niveli i shpenzimit të të hyrave vetjake ishte i ulët (72%).

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetjake	304,500	304,500	259,587	160,126	231,840

Inkasimi i të hyrave vetjake në vitin 2014 ishte 85% e planifikimit duke shënuar një rritje për 62% në krahasim me shumën e mbledhur në vitin 2013. Por, bazuar në faktin ekzistojnë shuma të mëdha të borxheve nga tatimpaguesit, me përmirësimin e strategjisë për arkëtimin e këtyre llogarive, performanca e të hyrave vetjake do të mund të rritej.

Rekomandimet

Çështja 5 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

E gjetura Realizimi i buxhetit në kategori të caktuara nuk është zhvilluar sipas planit, 12% të buxhetit për paga dhe mëditje kanë mbetur të pa shfrytëzuara për shkak të numrit më të vogël të të punësuarve në shëndetësinë sekondare, 81% të buxhetit për subvencione dhe transfere nuk janë shfrytëzuar për shkak të mos realizimit të planit të inkasimit të të hyrave vetjake. Një qasjet tjetër në Investime Kapitale, të ekzekutimit të të pothuajse gjysmës së shpenzimeve. Kjo në masë të madhe ka kufizuar mundësitë e ekzekutimit të projekteve të parapara për vitin 2014

- Rreziku** Për shkak të planifikimit të dobët, në fund të vitit komuna e Shtërpcës kishte suficite buxheti prej 12%. Si rezultat i kësaj, komuna kishte shmangie në realizimin e shumë objektivave, si në çështjen e rekrutimeve të lejuara, mosrealizimin e projekteve kapitale të vitit 2014 dhe në fusha tjera të shpenzimeve.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë një planifikim të kujdesshëm të buxhetit, duke vënë prioritetet e duhura në pagesën e obligimeve të mbetura nga vitet e mëparshme. Përveç kësaj, ecuria e ekzekutimit buxhetor duhet të jetë subjekt i monitorimeve të vazhdueshme, për tu siguruar se të gjitha veprimet me efekte financiare janë në kuadër të parametrave buxhetor.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Gjatë vitit 2014 komuna e Shtërpcës ka inkasuar të hyra vetjake në vlerë prej 259,587€, kryesisht nga tatimi në pronë, taksat nga lejet e ndërtimit, taksat e subjekteve biznesore, parkingjet publike, taksat administrative, dhënia e lejeve për prerje të pyjeve dhe gjobat e ndryshme policore.

Rekomandimet

Çështja 6 – Dobësi në raportimin e të hyrave- Prioritet i Mesëm

E gjetura Ekzistojnë mospërputhje të gjendjes së të hyrave nga taksat e inkasuara nëpër departamente të ndryshme të cilat inkasojnë të hyra dhe raporteve bankare. Përveç kësaj, të gjitha të hyrat nga taksat e ndryshme janë të regjistruar gabimisht në një kod të përbashkët „Taksat e tjera administrative“.

Rreziku Mospërputhja e gjendjes të të hyrave të inkasuara rrit rrezikun e kontrolleve të dobëta dhe paqartësinë e evidencave të sakta dhe mundësinë e gabimeve mbi të hyrat. Kjo ka për pasojë edhe raportimin e gabuar në Pasqyrat Financiare dhe redukton aftësinë e menaxhmentit për vendimmarrje të duhur.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të siguroj se në baza mujore do të zbatohet një praktikë e harmonizimit të rregullt të departamenteve për inkasimin e të hyrave, shërbimit financiar dhe raporteve bankare, dhe gjendja e debitorëve të komunës do të azhurnohet në mënyrë sistematike me regjistrimet e duhura.

Çështja 7 – Rregulloret e brendshme – Prioritet i Mesëm

E gjetura Komuna e Shtërpcës posedon një rregullore për inkasimin gjobave për ndërtime pa leje, mirëpo kjo rregullore ka mangësi, sidomos në përcaktimin e lartësisë së gjobave. Me fjalë të tjera, me rregullore nuk definohen qartë kriteret për caktimin e gjobës.

Gjithashtu, ekziston edhe një numër i madh i subjekteve joaktive biznesore, të cilat kanë borxhe të konsiderueshme ndaj komunës, por që nuk ishin ndërmarrë masat e duhura për të inkasuar prej tyre taksat e prapa mbetura.

Rreziku

Gjobat e parapara me rregullore nga 100 deri në 500€, pa përcaktimin e qartë të kriterëve për lartësinë e gjobës, lë mundësinë e keqpërdorimit nga ana e inspektorëve. Mundësia për keqpërdorim është edhe tek lirimi arbitrar i subjekteve joaktive biznesore nga pagesa e taksave për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, e që e ka shkaktuar paraqitjen e 700 ndërmarrjeve fiktive. Kjo mund të shkaktojë humbje të konsiderueshme financiare për komunën.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme t'i bëjë ndryshimet dhe plotësimet e rregullores së brendshme për gjobat për ndërtimet pa leje, si dhe të sigurojë zbatim rigoroz të rregullores së ndryshuar. Po ashtu, masa efektive duhet të aplikohen edhe për inkasimin e taksës për veprimtari biznesore.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Shpenzimet përmes prokurimit janë të gjitha shpenzimet për të cilat parashihet zbatimi i procedurave të prokurimit në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik (LPP). Këto shpenzime janë investimet kapitale dhe një pjesë e mallrave dhe shërbimeve. Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin edhe kërkesat për t'i zvogluar rreziqet në lidhje me vonesat në përfundimin e punëve, shmangien e konfliktit të interesave dhe ofertave jo të plota dhe arritjes së vlerës për para.

Rekomandimet

Çështja 8 – Dobësitë në shpenzimet përmes prokurimit – Prioritet i Lartë

E gjetura

Rishikimi ynë ka identifikuar mungesë të rishikimeve dhe kontrolleve efektive nga ana e menaxhmentit mbi shpenzimet përmes prokurimit. Kjo ka rezultuar me dobësitë në vijim:

- Janë kontraktuar shërbimet e mbrojtjes shëndetësore dhe ndihmës profesionale në spital në vlerë prej 350 eurosh në muaj për periudhën 20.06.2014 deri me 31.12.2014 (mbi 2,000€) dhe për shërbimet e paguara nuk ekziston asnjë dëshmi se ato janë kryer;

- Në lëndët që kishin të bënin me përdorimin e veturave private për qëllime zyrtare janë paguar 506 litra karburante dhe nuk kishte asnjë dëshmi nëse veturat janë përdorur për qëllime zyrtare; dhe
- Komuna kishte paguar për “Pastrimin e rrugës Vërbeshticë” shumën 6,900€ pa procedura të prokurimit për shkak të nevojës urgjente për pastrim.

Rreziku

Komuna ka dështuar të zbatoj rregullën financiare për shpenzimin e parave publik. Pagesat e çertifikuara, para se të arrihet siguria se janë pranuar mallrat/shërbimet e kontraktuara, rrit rrezikun e pagesave potencialisht të parregullta dhe keqpërdorimit të parasë publike, dhe për pasojë mund të shkaktoj humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 8

Kryetari duhet të analizoj arsyet pse pagesat e mësipërme kanë ndodhur dhe të merr masat ndaj personave përgjegjës, si dhe të siguroj se një praktikë e tillë e pagesave nuk do të përsëritet në të ardhmën.

4.4.2 Shpenzimet jashtë procesit të prokurimit

Përshkrimi

Shpenzimet jo përmes prokurimit kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime për të cilat nuk kërkohet prokurim. Shembuj të këtyre shpenzimeve janë komunalit, udhëtimet dhe drekat zyrtare, disa forma të bashkëfinancimit etj.

Rekomandimet

Çështja 9 - Dobësi në shpenzimet pa prokurim - Prioritet i Mesëm

E gjetura

Rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi lidhur me shpenzimet pa procedura të prokurimit për shkak të mungesës së rishikimeve efektive nga ana e menaxhmentit. Dobësitë janë si në vijim::

- Shpenzimet e përgjithshme të telefonisë mobile për vitin 2014 kanë qenë 14,838€. Me rishikimin e 13 numrave telefonik me Post Paid, është tejkaluar limiti për 337€ dhe gjitha tejkallimet janë pagur nga buxheti i komunës.
- Gjatë vitit 2014 janë shpenzuar 23,710€ për dreka zyrtare e që paraqet një shumë relativisht të lartë. Problemi i shpenzimeve të mëdha është duke u përsëritur nga viti në vit për shkak të mungesës së një rregulloreje të brendshme e cila do të përcaktonte limitet e lejuara për këto shpenzime, personat që kanë të drejtë reprezentacioni dhe obligimin e tyre që të dorëzojnë raporte të detajuara për qëllimin e këtyre shpenzimeve.

- Rreziku** Aprovimi i pagesave jashtë limiteve të lejuara për shpenzime telefonike dhe dreka zyrtare pa arsyetimet e duhura nga ana e menaxhmentit, rrit rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet që brenda një periudhe të arsyeshme të miratoj rregullore të brendshme për përdorimin e telefonisë mobile dhe për shpenzimet e drekave zyrtare, dhe të përcaktoj në mënyrë të qartë limitet e lejuara për këto shpenzime, si dhe të drejtat dhe obligimet e tyre. Ndërsa, paratë e shpenzuara jashtë limiteve të lejuara dhe pa aprovimin e menaxhmentit, t'i kthehen buxhetit të komunës.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga Komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Rekomandimet

Çështja 10 - Dobësi në paga - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Me kontrollin e listave të pagave kemi identifikuar se mësimdhënësit e të njëjtit nivel, me fondin e njëjtë të orëve dhe me kualifikime të njëjta, në njërin shkollë paguhen 382€, derisa në shkollën tjetër paguhen 519€. Këto diferenca janë për shkak që njëra shkollë i pranon disa kualifikime dhe përvojën e punës ndërsa shkolla tjetër nuk i pranon.
- Rreziku** Pagesa e stafit të nivelit të njëjtë me paga të ndryshme mund të shkaktojë dëme financiare dhe shkelje të së drejtës së punëtorëve për t'u paguar për shërbimin e ofruar.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të sigurojë se në të gjitha shkollat e komunës zbatohen kriteret e njëjta dhe bëhet trajtim i barabartë për të gjithë të punësuarit dhe se kompensimet e pagave bëhen në nivel të njëjtë.

Çështja 11 - Pushimi i lehonisë - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Rishikimi ynë ka identifikuar se në një rast zyrtares i është lëshuar vendimi për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë dy muaj pas lindjes. Poashtu, në pagat e përfituara gjatë pushimit të lehonisë është përfshirë shtesa për shërbyesit civil dhe lehona ka pranuar 70% të pagës edhe në muajin e shtatë të lehonisë. Kjo ka rezultuar me 516€ mbivlerësim të pagës për vitin 2014. Në anën tjetër zyrtarja i ka shfrytëzuar pushimet e mjekësore dhe të njëjtat nuk janë arsyetuar me raporte mjekësore.
- Rreziku** Pagesat e kryera për pushim të lehonisë nuk janë të rregullta, dhe si të tilla shkaktojnë humbje financiare për komunë. Mungesa e raporteve mjekësore për pushimin mjekësor mund të jetë subjekt i mashtrimit.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë se menaxheri i personelit do të jetë më i vëmendshëm në identifikimin e rasteve të tilla, dhe të gjitha vendimet dhe pagesat për pushime të lehonisë do t'i harmonizojë në pajtim me kërkesat ligjore. Shuma e mbipaguar prej 516€, duhet t'i rimbursohet komunës dhe praktikantët e tilla nuk duhet të përsëriten.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferuat

Përshkrimi

Komuna e Shtërpçës për vitin 2014, nga kategoria e subvencioneve ka shpenzuar 10,165€, prej gjithsej 53,040 sa i kishte të buxhetuara. Numri më i madh i subvencioneve u është ndarë përfituesve individual në formë të bursave për studentë dhe nxënës, ndihmave për mjekim, dhe të ngjashme por kishte edhe subvencione për organizimet sportive dhe për OJQ.

Rekomandimet

Çështja 12 - Zbatimi i rregullores dhe raportimi nga përfituesit - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Nga katër mostrat e kontrolluara në tri (1,470€) nuk kishte dëshmi të mjaftueshme nga përfituesit me anë të së cilës do të dëshmohej se subvencionet janë shpenzuar në përputhje me qëllimin e ndarjes.
- Nga shuma e përgjithshme e subvencioneve të ndara, 1,200€ janë regjistruar gabimisht në kodin 22 - Transferet.
- Rreziku** Mungesa e dëshmive për mënyrën e shpenzimit vë në pikëpyetje rregullsinë e subvencioneve të dhëna dhe mund të rezultojë me vlerë të ulët për para.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet për ndarjen dhe monitorimin e subvencioneve dhe të sigurojë se të gjitha procedurat dhe kriteret për ndarjen e tyre po zbatohen. Të gjithë përfituesit duhet të raportojnë për mënyrën e shpenzimit të subvencioneve.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Komuna e Shtërpcës në PVF e ka shpalosur pasuritë kapitale mbi 1,000€ në shumë 1,053,366€ dhe atë të pasurive nën 1,000€ në shumë 201,744€.

Ne kemi identifikuar një rrezik domethënës lidhur me plotësinë e pasurive (shih çështjen 1).

Rekomandimet

Çështja 13 – Puna e komisioneve për inventarizim/vlerësim të pasurive - Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna e ka emëruar zyrtarin e pasurisë dhe i ka themeluar komisionet për inventarizim dhe për vlerësim të pasurive. Komisioni për inventarizimin e pasurive ka filluar procesin e punës por deri në fund të auditimit tonë nuk e kishte përfunduar tërë procesin dhe nuk kishte përgatitur ndonjë raport. Si pasojë, komisioni për vlerësim të pasurive ende nuk ka filluar procesin e vlerësimit. Në anën tjetër, komuna nuk ka një zyrtar të logjistikës dhe ballafaqohet me problemin e mungesës së informatave për pranimet, disponueshmërinë (shlyerjen, shpenzimin ose tjetërsimin e pasurisë) dhe nuk ka të dhëna për stoqet.

Rreziku Mungesa e zyrtarit të logjistikës dhe progresit të pritur të inventarizimit/vlerësimit të pasurive vështirëson përcjelljen e shfrytëzimit të drejtë dhe ekzistimit. Kjo rrit rrezikun që pasuritë të dëmtohen, shkatërrohen, madje edhe të humben fare.

Rekomandimi 13 Kryetari i komunës duhet t'i analizojë arsyet e dështimit të komisioneve për ta kryer regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive kapitale dhe jo-kapitale. Kryetari duhet ta shqyrtojë rekrutimin e zyrtarit të logjistikës, kohën e emërimit të komisioneve dhe ta forcojë monitorimin e progresit të tyre duke siguruar raporte në kohë dhe regjistrim të aseteve në SIMFK dhe në sistemin e-pasuria.

4.5.2 Trajtimi i parasë së gatshme

Përshkrimi

Paraja e gatshme (petty-cash) është një fond i komunës për të mbuluar shpenzimet e përditshme dhe/apo të paparashikuara që nuk tejkalojnë shumën 100€.

Rekomandimet

Çështja 14 - Përdorimi i parasë së gatshme - Prioritet i Mesëm

E gjetura Ne kemi gjetur se paratë nga arka ishin shfrytëzuar kryesisht për t'i paguar shpenzimet e përfaqësimit, shpenzimet për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, për blerjen e ushqimit dhe pijeve, për shpenzimet gjyqësore, për mirëmbajtjen e objekteve si dhe për furnizimin e zyrave. Në arkën e njësisë së zjarrfikësve janë vërejtur ndarje të faturave me qëllim të shmangies së procedurave të prokurimit.

Rreziku Përdorimi i parasë së imët nga arka në mënyrë të gabuar, krijon hapësirë për keqpërdorimin e pagesave nga paraja e imët.

Rekomandimi 14 Kryetari rekomandohet që menjëherë të rishqyrtojë përdorimin e parasë së gatshme për të kufizuar përdorimin e parasë së imët.

4.5.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe bizneset i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Në PVF e vitit 2014 vlera e të arkëtueshmeve është 1,220,193€.

Rekomandimet

Çështja 15 - Nivel i lartë i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna nuk ka ndërmarrë masa efektive dhe të mjaftueshme për inkasimin e llogarive të arkëtueshme për vitin 2014, si edhe për vitet e mëhershme. Llogaritë e arkëtueshme gjatë vitit 2014 janë rritur për 196,439€ duke arritur në 1,220,193€.

Rreziku Rritja e shumës së të arkëtueshmeve nga viti në vit e zvogëlon mundësinë e komunës për planifikimin dhe zbatimin e projekteve kapitale të cilat do të financoheshin nga të hyrat vetjake. Po ashtu, ekziston rreziku që për shkak të mos ndërmarrjes së masave për inkasimin e të arkëtueshmeve, tatimpaguesit dhe subjektet biznesore të krijojnë përshtypje se nuk është e domosdoshme të paguajnë borxhet.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të iniciojë hartimin e një strategjie që do të përcaktonte të gjithë hapat dhe masat e duhura për të rritur shkallën e inkasimit të këtyre llogarive. Duhet të ndërmerren masa për zbatim efektiv pas aprovimit. Masa ligjore duhet të aplikohen sipas nevojës.

4.5.4 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Komuna e Shtërpcës në PVF e vitit 2014 ka paraqitur vlerën borxheve prej 1,011,017€. Niveli i lartë i borxheve nga vitet paraprake dhe në vitin 2014 ka krijuar vështirësi financiare për komunën.

Zvogëlimi i përshkruar i obligimeve në fillim të vitit 2014 është rezultat i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore (shih kapitullin 4.3).

Rekomandimet

Çështja 16 – Hyrja në obligime pa zotime të fondeve - Prioritet i Mesëm

E gjetura Praktika e gabuar lidhjes së marrëveshjeve me palët e treta pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore është përsëritur prapë sikurse edhe viteve paraprake.

Rreziku Pagesa e borxheve në bazë të vendimeve të gjykatës e kanë rrezikuar realizimin e projekteve të parapara për vitin 2014, derisa vazhdimi i praktikave të njëjta mund të çrregulloj të gjitha aktivitetet jo vetëm në vitin 2015, por edhe në vitet e ardhshme.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të inicioj diskutimet me Qeverinë dhe Ministrinë e Financave që të gjej zgjidhjen e duhur lidhur me shlyerjen e borxheve të mbetura. Po ashtu, kryetari duhet të vendos kontrole të forta mbi planifikimet buxhetore dhe në të ardhmen duke siguruar të mos iniciohet asnjë projekt pa zotimin paraprak të fondeve.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia i Auditimit të Brendshëm (NJAB) si pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm në komunën e Shtërpcës kanë një auditor (drejtor i NJAB). Kjo njësi i ka audituar disa fusha të caktuara të aktiviteteve të komunës në bazë të planit trevjeçar strategjik (2014-2016), dhe planit vjetor të auditimit i cili e nënkupton auditimin e prokurimit publik; menaxhimit të pasurive; kontrollin e kontratave të punës të të punësuarve; të hyrat vetjake nga njësia e Gjeodezisë, Kadastrës dhe tatimit në pronë; të hyrave nga lejet e ndërtimit si dhe sistemin e kontrollit të shpenzimit të mjeteve për mallra dhe shërbime në ambulanca.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka arritur ta realizoj planin vjetor, dhe konkluzioni ynë është se këto raporte i kanë kontribuar menaxhmentit të ketë një pasqyrë të qartë të nivelit të sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efikasitetit të tyre.

Menaxhmenti i ka përgatitur planet e veprimit dhe është angazhuar në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Rekomandimet

Çështja 17 - Mungesa e Komitetit të Auditimit - Prioritet i Lartë

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar që komuna e Shtërpcës ende nuk e ka themeluar Komitetin e Auditimit sepse mungon kuptimi i rëndësisë së këtij komiteti nga ana e menaxhmentit.

Rreziku Mungesa e Komitetit të Auditimit mund të rezultojë me zvogëlim të rolit dhe ndikimit të punës së NJAB-së.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurojë funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Duhet të themelohet Komiteti i Auditimit brenda një afati të arsyeshëm kohor më së largu deri në fund të vitit 2015. Auditimi i Brendshëm duhet të ndërmarrë auditim të bazuar në rrezike për t'i ofruar menaxhmentit siguri në fushat kyçe financiare/operative.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht

ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e

auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet ti analizojë arsyet si për keq-deklarimin fillestar të pasurive ashtu edhe për mos ndjekjen e këshillave të ZAP-it në fazën e ndërmjetme për adresimin e tyre. Duhet të merren masa të duhura për të siguruar shpalosje të saktë të pasurive në PVF të vitit 2014 mbështetur me funksionim efektiv dhe me kohë të komisionit të inventarizimit.			Rekomandim i pa zbatuar
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Planin e implementimit duhet të rishikohet nga Kryetari i komunës në baza tremujore.		Rekomandim pjesërisht i zbatuar	
4.1 Qeverisja e mirë	Kryetari të zbatojë një rishikim për të përcaktuar formatin e raportimit financiar për menaxhmentin e lartë që është kërkesë për mbështetjen e një menaxhimi efektiv të punës. Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë qeverisëse ku menaxhmenti i lartë është i njoftuar mbi dobësitë e kontroleve dhe ti menaxhojë ato në mënyrë aktive.	Rekomandim i zbatuar		
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit paraprihet me një proces rigoroz të vlerësimit i cili pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar / sfidat e pritura të vitit, etj. Theks i veçantë duhet të vendoset në identifikimin e barrierave dhe mundësive në rritjen e shkallës së ekzekutimit të investimeve kapitale dhe veprime të duhura duhet të merren për të adresuar këto pengesa dhe të shfrytëzohen mundësitë e identifikuara. Monitorimi efektiv gjatë vitit buxhetor duhet të aplikohet kur një veprim në kohë është marrë për të adresuar variancat kundrejt shpenzimeve të planifikuara.		Rekomandim pjesërisht i zbatuar	

<p>4.3 Të hyrat</p>	<p>Kryetari duhet të zbatojë rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës. Referenca duhet të bëhen me komunat tjera të ngjashme për të përcaktuar nëse praktikat efektive në vende të tjera mund të zbatohen në nivel lokal.</p> <p>Kryetari të zbatojë një rishikim sistematik për të përcaktuar bizneset aktive në komunë dhe për të siguruar që të gjithë të kenë leje të biznesit dhe janë faturuar për tatimin e biznesit në vitin 2014.</p>		<p>Rekomandim pjesërisht i zbatuar</p>	<p>Rekomandim i pa zbatuar</p>
<p>4.4 Shpenzimet</p>	<p>Kryetari duhet të zbatojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar se përse disa kërkesa specifike të prokurimit nuk adresohen tek të gjitha prokurimet dhe të zbatojë kontrolle të zgjeruara për të siguruar që të gjitha dobësitë e identifikuar sistematike janë adresuar në mënyrë efektive.</p> <p>Kryetari duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit janë aplikuar në mënyrë jo-konsistence në rastet e mësipërme dhe të zbatojë kontrolle të zgjeruara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet, dhe të ndërmerren masa administrative sipas nevojës.</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pagesat e ardhshme për qira bëhen neto nga tatimi në burim dhe aty ku është praktike të sigurojë se të gjitha ndërtesat komunale përdoren vetëm për aktivitetet e komunës. Përdoruesit që nuk janë pjesë e komunës duhet të ngarkohen me një qira sipas tregut.</p> <p>Kryetari duhet të rishikojë kontrollet ekzistuese mbi përdorimin e automjeteve dhe për përmirësimin e tyre dhe / apo rishikimin mbikëqyrës për të siguruar se përdorimi i automjeteve i përmbahet rregullores për përdorimin e automjeteve të komunës.</p>		<p>Rekomandim pjesërisht i zbatuar</p>	<p>Rekomandim i pa zbatuar</p> <p>Rekomandim i pa zbatuar</p> <p>Rekomandim i pa zbatuar</p>
<p>4.4.4 Subvencionet</p>	<p>Kryetari duhet të shqyrtojë rastet e identifikuar për të përcaktuar se pse kriteret nuk janë aplikuar dhe të zhvillojë kontrolle të zgjeruara për të</p>			<p>Rekomandim i pa zbatuar</p>

dhe Transferet	shmangur përsëritjen e rasteve të tilla.			
4.5 Trajtimi i Borxheve	Kryetari duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë për të siguruar zgjidhjen e kësaj situate. Për më tepër, Kryetari i komunës duhet patjetër të ndërpres praktikën e hyrjes në obligime para se fondet të jenë zotuar.			Rekomandim i pa zbatuar
4.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë themelimin e KA, i cili aplikon praktika të mirë dhe të sigurojë se NJAB kryen punën në mënyrë cilësore dhe në pajtim me standardet dhe praktikatat e mira.			Rekomandim i pa zbatuar